

KADJANI DHE BESIMET E TIJ

Shkruar nga:

Prof. Mendhur Ahmed Xhenjuti

Shef i departamentit qendror të thirrjes islame dhe dekan i fakultetit të gjuhës arabe në Xhenjut, Pakistan. Sekretar i përgjithshëm i bashkësisë së dijetarëve islam në zonën e Penxhabit, Pakistan.

1394 h / 1975 e.s

OPINIONI I SHEJH HASENIN MUHAMED MAHLUF EL-HANEFI

Ish kryemyftiu i Egjiptit dhe anëtarë i këshillit të dijetarëve të mëdhenj të Ez-herit, gjithashtu dhe anëtarë i këshillit formues të “*Lidhjes së Botës Islame*” me qendër në Mekë.

Pasi e lexova këtë broshurë jam i mendimit se është e mjaftueshme dhe përmbledhëse për temën që trajton. Ajo zbulon më së mirë para nesh besimet e sektit të Kadjanit dhe lajthitjet e tij. Për këtë arsye këshilloj që të përhapet në masat e gjera për të ndriçuar mendjet dhe të vërtetën si dhe për tu ruajtur nga rruga e shtrembër dhe injoranca në çështjet e fesë.

Shkroi:

Hasenin Muhamed Mahluf

12 Rebiul Euel 1394 h. (5 Prill 1974)

PARATHËNIE

Nga Shejh muhadith prof. Muhamed Jusuf El-benurij drejtor i përgjithshëm i akademisë së shkencave islame në Karaçi, Pakistan.

Lavdia i përket vetëm Allahut Zotit të botëve. Uratat dhe bekimet qofshin për vulën e profetëve Muhamedin (alejhi selam) për familjen dhe gjithë shokët e tij.

Myslimanët që në kohët më të hershme e deri më sot kanë kaluar nëpër sprova dhe provokime të mëdha të cilat janë bërë pengesë serioze në ngritjen e Islamit dhe përhapjen e tij. Ngjarje të tilla për pak sa nuk i kanë tronditur themelet e fesë së Muhamedit sikur të mos kishte qenë kujdesi hyjnor, i cili e ruajti dhe bëri atë të qëndrueshëm. Hauarixhët, shiat, keramijet, kaderijet...etj, kanë lënë ndikimin e tyre të keq, duke shkaktuar turbullira që kanë lëvrirë në tokat islame dhe që pasojat e tyre vazhdojnë të ndihen edhe sot e kësaj dite. Por Allahu vazhdimisht ka nxjerrë prej këtij umeti dijetarë dhe autoritete të palëkundshme në mbrojtje të fesë dhe ruajtjes së paprekshmërisë së saj nga depërtimet e qafirëve dhe heretikëve. Kjo fe mbeti dhe do të mbesë nëpër faqet e historisë, e qartë dhe rrezatuese, duke verbuar me shkëlqimin e saj të ndritshëm sytë e ateistëve, të pafeve dhe heretikëve.

Një nga sprovat më të mëdha që ka kaluar ky umet në këtë shekull të fundit është edhe trazira që shkaktoi dalja në skenë e Mirza Gulam Ahmed El-kadjanit nga India, i shtyrë dhe i mbështetur nga makinacionet e qeverisë britanike gjatë kohës së sundimit në Indi. Kadjani eci shkallë-shkallë në pretendimet e tij, në fillim u shfaq si një ripërtëritës i fesë, më pas pretendoi se ishte profet joligjëvënës, por nuk do të zgjaste shumë dhe ai përsëri do të shfaqte një pretendim të ri tashmë duke thënë se, ishte një profet dhe i dërguar ligjvënës, të cilit i vjen shpallja nga Allahu, ashtu sikurse Kurani i erdhi Profetit tonë (alejhi selam). Ky njeri përdorte gjatë propagandës së tij edhe mjaft ajete, të cilat i shkëputte nga Kurani dhe ia vishte vetvetes, gjoja se ato kishin ardhur për të. Në interpretimet e tij ai ndoqi rrugën e batinijve dhe heretikeve, sidomos eci në gjurmët e Bahaizmit. Për të maskuar fjalët e tij ai nuk u mjaftua me kaq, por sajonte edhe përngjasime me mrekullitë të Profetit tonë, vulës së gjithë profetëve. Xhaminë e tij e quajti si xhamia El-Aksa ndërsa fshatin e tij e bëri Mekën e Mesihut, e Lahoren qytetin e tij. Xhamisë së tij i bëri një minare të cilën e quajti 'Minarja e Mesihut'. Kadjani ngriti edhe një varrezë të cilin e emërtoi si 'Varreza e Xhenetit'. Çdo njeri që do të varrosej në të ai do ishte prej banorëve të Xhenetit. Ky njeri e uli Isain (alehji selam) në sy të njerëzve sa që çdo kush me të drejtë do të revoltohej. Nuk është parë ndonjëherë në botë që ndonjë 'profet' të sulmojë një tjetër profet! Ai i konsideroi si të pa fe të gjithë ata që nuk e besonin në të, ashtu siç pretendonte se qeveria britanike ishte hija e Zotit në tokë, madje në disa nga shkrimet e tij¹ ka përmendur se Kadjanizmi është një pemë e mbjellë nga vetë britanikët.

Ky njeri solli me vete gjithfarë fatkeqësish e belash, duke u zhytur thellë në pellgjet e kufrit dhe heretizmit. Në fillim trazira e tij nisi e dobët dhe pa përkrahje, por më pas do të rritej e përhapej sa që do të bëhej një shqetësim serioz.

Përballë kësaj rryme të kufrit do të dilnin dijetar të shquar që do t'i kundërviheshin asaj me gjuhë dhe me penë dhe gjithë mundësitë që ata kishin. Një nga ata dijetar që iu kundërvunë atij ishte edhe Muhamed Enuer Shah nga Kashmiri, krue i mësuesve në shkollën Darul Ulum në Diuband. Ai shkroi disa libra në gjuhën arabe dhe perse në mbrojtje të fesë islame, i nxituri dhe i ndihmuar nga miqtë dhe nxënësit e tij. E megjithatë prapë ekzistonte nevoja për shkrime të tjera ku do të bëheshin të ditur besimet e këtij sekti qafir (renegat), pa pasur nevojë për t'iu kundërpërgjigjur atyre, por vetëm duke cituar besimet e Kadjanit dhe referencat nga janë marrë, pasi vetë përmbajta e tyre tregon pavlefshmërinë që kanë. Për këtë qëllim autori i këtij libri dha

1- Teblig Risaleh. V. 7. fq.19.

kontributin e tij duke përmbledhur citatat më të shëmtuara të Kadjanit dhe doktrinat e tij më të çmendura saqë për çdo njeri bëhet e qartë kufri dhe djallëzia e tij, pa pasur fare nevojë për replika ndaj tyre. Allahun e lusim që ta pranojë këtë punë për hir të Tij.

FJALA E AUTORIT

Lëvdatat i qofshin Allahut të vetëm e të pa shoq, e ndërsa bekimet e uratat për atë, pas të cilit nuk ka më profet, e as ka umet pas umeti të tij e as libër pas librit të tij, si dhe mbi gjithë familjen e shokët e tij, e mbi të tërë ata që ndjekin rrugën e tij, paqe dhe mirësi paçin deri në Ditën e Gjykimit.

Mirza Ghulam Ahmed Kadjani, u shfaq në fund të shek. XIX më 1840 në Indi në krahinën e Penxhabit. Ai pretendoi se ishte Profet dhe i konsideroi si të pa fe të gjithë ata që nuk besonin në profecinë e tij të rreme. Në këtë mision një rol kryesor luajti edhe qeveria Britanike madje ishte vetë ajo që e mbolli këtë farë me duart e saj, siç e pranon këtë edhe vetë Kadjani, ashtu siç bëri gjithçka për ta mbrojtur dhe ndihmuar atë derisa ai u kthye plotësisht në një vegël të këtij kolonizatori. Ky i vetëshpallur profet, trumbetoi me të madhe se Xhiahadi qe shfuqizuar dhe se bindja ndaj qeverisë britanike ishte një obligim i domosdoshëm. Kjo propagandë u shpërnda në çdo vend madje edhe në zemër të Islamit në Mekë. Ky njeri e shndërroi vendlindjen e tij Kadjanin në një qendër nga ku donte të përhapte thirrjen e tij në tërë Indinë, derisa vdiq po aty në Maj të 1908 nga sëmundja e kolerës. Më pas India do të ndahet dhe në vitin 1948 do të formohet Pakistani, ku edhe aty ndjekësit e tij do të ngrenë një qytezë të re që do ta mbiquajnë “Rebuah” për ta bërë këtë një qendër thirrje e propagande brenda Pakistanit dhe jashtë tij.

Dijetarët islamë që në ditët e para të lindjes së kësaj rryme e luftuan atë me gjuhë dhe me penë dhe shpallën kufirin e tij dhe të gjithë atyre që ndjekin atë, ata janë renegatë dhe të dalë jashtë Islamit. Për këtë ata shkruan edhe materiale të shumta e mjaftë të vlefshme .

Tani po paraqesim për ju vëllezër mysliman një pasqyrë të shkurtër të pretendimeve të të vetëshpallurit profet:

1-Pretendoi se ishte profet.

2-Tha se Isai (alejhi selam) ka vdekur.

3-I konsideroi si të pa fe të gjithë ata që nuk i besojnë profecisë së tij të rreme.

4-Mbështeti me të gjitha mundësitë kolonializmin anglez.

5-Xhiahadin e shpalli si haram për sot e për mot.

6-Krijoi simbole dhe shenjtëri të reja.

7-Kadjani pretendoi se qëndron mbi të gjithë profetët madje edhe mbi H. Muhamedin (alejhi selam)...etj.

Jemi munduar që të jemi korrekt në përmendjen e civateve me numrat e faqeve dhe librat nga të cilat janë nxjerrë pa shtuar ose hequr nga origjinali asgjë. Aty ku e kemi parë të nevojshme

kemi venë shënime në fund të faqes.² Allahut i kërkojmë sukses në arritjen e së vërtetës, Ai është i mundshëm për gjithçka!

KADJANI DHE BESIMET E TIJ

Pretendimet e Kadjanit

Ai pretendoi se ishte: Muxhedid (ripërtëritës i fesë), Mehdiu, Mesihu, Lajmëtarë, i Dërguar... etj.

1- “Zemrat kanë vdekur, mëkatet janë thelluar, fatkeqësitë janë shtuar. Dhe mu në këtë natë të errët dhe errësirë të thellë mëshira e Allahut përcaktoi dritën e qiellit. Unë jam ajo dritë dhe ai reformator, Mesihu i pritur. Unë kam një pozitë tek Zoti im që asnjë nga njerëzit nuk e di.” (Hutbetul Ilhamije, fq.51)³

2-Lum për ju që iu ka ardhur Mesihu i pritur nga i Plotfuqishmi, ai vërtetë ka për dhunti një gjuhë elokumente! Lum si ju se për ju ka ardhur Mehdi i premtuar me pasuri të shumtë e mirësi të pandërprerë! O ju njerëz unë jam Mesihu muhamedan dhe Ahmedi Mehdi. (Hutbetul Ilhamije, fq 60-61, 98)

3- Unë jam Mesihu i premtuar të cilit i është caktuar ardhja në kohën e fundit nga Allahu i madhëruar. Unë jam ai që më është dhuruar mirësia për të cilën tregohet te (surja) Fatiha kur flitet për dy grupet. (Hutbetul Ilhamije, fq.179)

4- Nëse thuhet se Mesihu është krijuar pa baba nga dora e fuqisë dhe se kjo është diçka e jashtëzakonshme, atëherë paralelizmi nuk do të jetë i plotë nëse nuk do të ketë një përngjasim (ndërmjet Kadjanit dhe Isait (alejhi selam))

Le të themi se me të vërtetë krijimi i njeriu pa baba është brenda ligjit të Allahut të plotfuqishëm... e pranojmë se kjo është një diçka e rrallë në traditën e lindjeve njerëzore.⁴ Por i tillë ishte edhe krijimi im nga Allahu. Ky krijim ishte i përngjashëm me lindjen e Isait në

² Shënimet e autorit janë lënë pa ndonjë shenjë të veçantë ndërsa ato të përkthyesit shoqërohen me inicialet: sh. përkth.

³ Ja seç thotë Kadjani për këtë libër: “Ky është ai libër i cili mu frymëzua një pjesë e tij nga Zoti i njerëzve në një ditë feste. E lexova atë para të pranishmëve me shqiptimin e Shpirtit besnik, të pashkruar e të pa qëndisur. Pa dyshim që ai është një mrekulli prej mrekullive. Nuk është e mundur që një njeri si unë t’i shqiptonte ato fjalë të pa shkruara dhe të thoshte të tilla shprehje...Nuk ke për t’i gjetur këto njohuri në fjalët e urta të mbledhura nga mendjet e mençura. Porse ato janë realitete të cilat mu shpallën nga Zoti i krijësave. A mund të ketë për Mesihun të fshehta? A mund të ketë pas vulës së prijësve në jetë më vulë? Nuk është ndonjë çudi që të dëgjosh nga vula e prijësve çështje, të cilat nuk i ke dëgjuar më parë nga dijetarët e fesë. Porse më e çuditshme se gjithçka është fakti që të vijë Mesihu i pritur, Imami i premtuar, gjykuesi i njerëzve dhe vula e Kalifëve e mos të vijë me ndonjë njohuri të re nga providenca hyjnore, e të flasë siç flasin dijetarët e rëndomtë, e të mos dalloj dot ndërmjet errësirës dhe dritës. Unë e quajta këtë libër “Ligjërata e Frymëzuar” sepse unë e mësova atë si frymëzim nga Zoti im, dhe ishte një mrekulli. (fq.1)

⁴ Në fakt është i vetmi rast, historia njerëzore nuk ka vërtetuar raste të ngjashme me atë të lindjes së Isait, mirëpo Kadjani e bën këtë për ti ulur rëndësinë këtij fakti dhe për të dhënë jetë atij krahasim qesharak. (sh.përkth)

rrallësi. Ky përcaktim do të mjaftonte për një njeri të mençur (kur të mësoj) se, unë linda i binjakëzuar! Me mua lindi edhe një vajzë po në këtë fshat, ajo vdiq e unë mbeta gjallë me dëshirën e Zotit të madhëruar. Pa dyshim që kjo ngjarje është diçka e rrallë në krahasim me traditën e njohur njerëzore... E veç kësaj unë jam dërguar dhe jetoj mes dy sëmundjeve. Një sëmundje në të çarën e poshtme (urinimi i shpeshtë gjatë ditës dhe natës) dhe tjetra në pjesën e sipërme (marrje mendsh dhe kriza nervore) dhe kjo është diçka edhe më e habitshme se sa lindja e Mesihut e pra një mrekulli për çdo njeri që e dëgjon. (Hutbetul Ilhamije, 85,86,87)

5-Unë jam Mesihu dhe më të vërtetën eci dhe thërras... se Isai vdiq dhe nuk jeton sikurse ju. (Tuhfetu Nedueh, fq.1)

6-Unë jam Mesihu dhe unë jam fjala e (Allahut) dhe unë jam Muhamedi e Ahmedi i zgjedhur. (Terjak El-kulub, fq.3)

7- Unë u ktheva në Merjem dhe qëndrova i tillë për dy vjet e më pas tek unë u fry shpirti i Isait ashtu siç qe fryrë tek Merjemja dhe në mënyrë metaforike mbeta shtatzënë dhe mbas disa muajsh, pa i kaluar dhjetë muaj, u ktheva nga Merjeme në Isa dhe kështu me këtë mënyrë u bëra biri i Merjemes. (Sefinet Nuh, fq 46)

8-Allahu më quajti Merjem, e cila u mbars me Isain dhe jam unë ai që kihet për qëllim në fjalën e Allahut: ***“e Merjemen të bijën e Imranit e cila e ruajti nderin e saj dhe tek ajo frymë prej shpirtit tonë”***

Kjo sepse unë jam i vetmi ai që pretendoi të ishte Merjemja dhe tek unë u fry Shpirti i shenjtë. (Hashijetu Hakikatul Uahj, fq.337)

9-Unë e pash veten në një rast zbulese sikur isha grua dhe Zoti shfaqti tek unë forcën burrërore. Kjo shenjë mjafton për një të mençur që kupton. (Dahijetul Islam, fq.34 Lijor Muhamed Kadjani mësues i Mirza Beshirudin Mahmud i biri i Kadjanit)

10-Mua më qe shpallur nga Zoti im para se të shfaqej murtaja se: *“Ndërtoje anijen para syve tanë dhe me frymëzimin tonë dhe mos mu drejto Mua për ata që bën padrejtësi dhe humbën. Nuk ka dyshim se ata do të mbyten⁵, sigurisht se ata që të japin besën ty ata po ia japin besën Allahut dora e Allahut është sipër dorës së tyre”⁶* (Hutbetul Ilhamije, fq.187,188)

11-Vështroni se si tani Allahu e bëri atë që më shpalli mua, mësimet e mia dhe besën time të ngjashme me barkën e Nuhut duke e shndërruar atë në një barkë shpëtimtare për mbarë njerëzit. (Erbein, nr.4 fq.6)

12- Zoti im më ka shpallur se unë jam sikurse barka e Nuhut për krijesat. Kushdo që vjen në besën time shpëton prej humbjes, lum për ata njerëz që shpëtojnë! (Mirat Kemal El-islam, fq.486)

13-Shembulli im te Zoti është sikurse shembulli i Ademit... e pra Allahu më bëri Adem dhe më dha gjithçka që i dha babait të njerëzimit. (Hutbetul Ilhamije, fq.253,254)

⁵ Në të vërtetë këto fjalë janë shkëputur nga Kurani nga surja Hud: 37 kur Allahu i drejtohet Nuhut (alejhi selam), mirëpo Kadjanit nuk i vjen aspak turp që bën plagjarizëm të tillë.(sh.përkth)

⁶ Marr nga sureja Feth: 10, fjalë të cilat Allahu ia drejton Muhamedit (alejhi selam) e që Kadjani i përshtat për veten e tij! (sh.përkth)

14-Thirrja ime është se unë jam resul (mesazhier i Zotit) dhe nebij (lajmëtar i Zotit). (Gazeta Bedr, 5 Mars 1908)

15- Unë u njoftova (nga Zoti) se: “Lajmi për ty gjendet në Kuran dhe Hadith dhe, ti je ai që përmendet në këtë ajet: “(Zoti) **Është ai i cili dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim dhe fenë e vërtetë për ta shfaqur atë mbi të gjitha fetë.**” [suret Saff:8] (I’xhazul Ahmedij, fq.9)

16-Allahu është i vërteti, Ai i cili dërgoi të dërguarin e Tij në Kadjan. (Dafiul El-bela, fq. 11)

17-Ne e zbritëm atë pranë Kadjanit dhe e zbritëm me të vërtetën dhe me të vërtetën zbriti, dhe urdhri i Allahut ka qenë i kryer. (Enxhuman Atihim, fq 54)

18-Si mund ta hedh poshtë atë që më shpalli Allahu për njëzet e tre vjet pa ndërprerje. (Hakikatul Uahj, fq.15)

19-Allahu është trupëzuar tek profetët. (Anxhame Atihim. Fq.53)

20-Ti je mes tyre në gradën e Musait prandaj duro për çka thonë për ty. (Anxhame Atihim, fq.55)

21-Përgëzime për ty o Ahmed! Ti je qëllimi im dhe Unë jam me ty, Unë jam Ruajtësi yt, Unë do të bëj ty prijës për njerëzit.⁷ (Anxhame Atihim fq 55)

22- Lëreni të përmendurit e birit të Merjemes, sepse Gulam Ahmedi është më i mirë se ai. (Dafiul El-bela fq. 20)

23-Shikoni se, unë erdha ashtu siç pat përgëzuar për mua Profeti (alejhi selam), Isai nuk mundet ta vërë dot këmbën e tij në minberin tim (vendi ku mbahet hutbja). (Izalet Euham, fq.69)

24-Shfaqja e tij (e Kadjanit) konsiderohet tek Allahu si shfaqja e Profetit të Tij Mustafa dhe koha e tij si përfundimi i miraxhit kohor për të dërguarin e zgjedhur, dhe shkëlqimi maksimal shpirtëror i zotnisë tonë (Muhamedit alejhi selam) më të mirit të krijesave. (Hutbetul Ilhamije fq.297)

25- Ai që hyn në radhët e xhematit tim ka hyrë në radhët e sahabeve të zotnisë tim, më të mirit të profetëve. (Muhamedit (alejhi selam)) (Hutbetul Ilhamije, fq 258)

26-Ai që bën ndarje ndërmjet meje dhe ndërmjet Mustafasë nuk më ka njohur ashtu siç duhet. (Hutbetul Ilhamije, fq.258)

27-Thuaj: Nëse e doni Allahun më ndiqni mua që Allahu t’iu dojë juve⁸. (Enxhuman Atihim, fq.56)

28-Nuk të kemi dërguar ty veçse mëshirë për botët.⁹ (Enxhuman Atihim, fq.78)

29-Sikur të mos ishe ti nuk kisha për t’i krijuar qiejt.¹⁰ (El-istifta, fq.58)

⁷ Kjo shprehje e fundit është vjedhur nga Kurani, surja Bekare ku Allahu i drejtohet Ibrahimit (alejhi selam) (sh.përkth)

⁸ Vjedhur nga surja Ali Imran :31, fjalë që i drejtohen Muhamedit (alejhi selam)(sh.përkth)

⁹ Vjedhur nga surja Enbija: 107, fjalë që i drejtohen Muhamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

¹⁰ Hadith i joautentik që në fakt i drejtohet Muhamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

30-Ne kemi dërguar tek ju një të dërguar ashtu siç patëm dërguar tek Faraoni të dërguar.¹¹ (Hakikatul Uahj, fq.101)

31-Mos kij frikë, vërtetë që të dërguarit nuk friksohen para meje¹². (Hakikatul Uahj, fq.91)

32-Me të vërtetë që Ne të kemi dhënë ty fitore të qartë. Që Allahu të të falë ty gjynahet e shkuara dhe të ardhme. A nuk është Allahu Ai që i mjafton robit të Tij.¹³ (Anxhame Atihim, fq.58)

33-Kadjani është ai që përgëzohet në këtë ajet: **“dhe përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i tij është Ahmed.”**¹⁴ (Ainet Sadakat, fq 36. i të birit të Kadjanit Mahmud Ahmed)

34-**“Muhamed është i dërguari i Allahut dhe ata të cilët besuan me të...”**¹⁵ Në këtë shpallje hyjnore unë quhem Muhamed dhe i dërguari i Allahut. (Ik Galtij Ke Izalah, fq.3)

35-(Zoti) më ka dhënë atë që s'ia ka dhënë asnjërit prej njerëzve. (Tedhkireh, fq.658)

36-Të kemi vlerësuar ty më shumë se këdo tjetër. (Tedhkireh, fq.709)

37-Ne të kemi dhënë ty Keutherin.¹⁶ (Anxhame Atihim, fq.58)

38-Atë që Allahu i dha çdo profeti një nga një mua ma dha të gjithën përnjëherë. (Nuzul El-Mesih, fq.99)

39-Shumë frone kanë zbritur nga qielli porse froni yt është ngritur mbi të tjerët. (Tedhkireh, fq.346, 648)

40-Allahu ty të vuri mbi çdo gjë. (Tedhkireh, fq. 469, 579, 637)

41-Dhe kështu lindi shenjtëria e Profetit tonë (alejhi selam) në mijëvjeçarin e pestë me cilësitë e tij më të bukura. Ishte ajo koha e ngritjes më të lartë, madje pararoja e lartësismit të përsosur. Më pas kjo shenjtëri do të përsosej e do të shfaqej në fund të mijëvjeçarit të gjashtë. Nënkuptoje me të këtë kohë. Ashtu siç Ademi u krijua në fund të ditës së gjashtë me urdhrin e Allahut më të Mirit Krijues. Më pas shenjtëria e Profetit tonë, më të mirët profet, do të rishfaqej tek njëri prej pjesëtarëve të umetit të tij, për të arritur përsosmërinë e shfaqjes dhe forcën e dritës së tij, ashtu siç pat premtuar Allahu në librin e Tij të qartë. Unë jam kjo rishfaqje e premtuar dhe dritë e shumëpritur, prandaj beso dhe mos u bëj prej qafirëve. Nëse do, mund të lexosh fjalën e Allahut: **“(Zoti) Është ai i cili dërgoi të dërguarin e Tij (Muhamedin alejhi selam)¹⁷ me udhëzim dhe fenë e vërtetë për ta shfaqur atë mbi të gjitha fetë.”** (suret Saff:8)

Mendo pra si njeri i udhëzuar sepse kjo është koha e përsosmërisë së kësaj rishfaqje hyjnore nga i Gjithëfuqishmi, o ju mysliman! (Hutbetul Ilhamije, fq.266,268)

¹¹ Vjedhur nga surja Muzemil:15 , fjalë që i drejtohen Muhamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

¹² Vjedhur nga surja Neml:10, fjalë që i drejtohen Musait (alejhi selam) (sh.përkth)

¹³ Vjedhur nga surja Feth:1-2, fjalë që i drejtohen Muhamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

¹⁴ Ajeti 5 surja Saff. Këto fjalë janë fjalët e Isait që përgëzon për ardhjen e Muhamedit (alejhi selam) e jo të Kadjanit. (sh.përkth)

¹⁵ Sure Feth:25 .(sh.përkth)

¹⁶ Ajeti i parë i sures Keuther nga Kurani. Fjalë që i drejtohen Muhamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

¹⁷ Me këtë ajet Kadjanit nënkupton vetveten. (sh.përkth)

42-Dhe kishte mbetur vendi bosh për një tullë, do me thënë për atë i cili do të nderohej në këtë ndërtesë. Allahu desh që ta plotësonte ndërtesën e tij me këtë tullë të fundit, unë jam ajo tullë¹⁸, o ju që kundërshtoni! (Hutbetul Ilhamije, fq. 177, 178)

43-Kopshti njerëzor vazhdonte të ishte i mangët deri më sot, por tashmë me ardhjen time u plotësuan gjethet dhe frytet e tij. (Berahin El Ahmedije, v.5 fq.113)

44-Muhamedi zbriti përsëri në mes nesh, por ai këtë herë është edhe më madhështor sesa herën e parë. Ai i cili dëshiron të shoh Muhamedin me pamjen e tij më të përsosur le të shoh Gulam Ahmedin në Kadjan.¹⁹ (Gazeta kadjane “Bedr” 25 Tetor 1906)

45-Për të (Muhamedin alejhi selam) u mbulua Hëna e ndritshme, e ndërsa për mua Hëna dhe dielli u shuan. Fjalët e tij ishin një mrekulli dhe argument për të, po kështu dhe unë kam një fjalë që mbi të gjithë shkëlqen. (Ikhaz Ahmedij, fq.79)

46-Profeti (alejhi selam) pati tre mijë mrekulli. (Tuhfetul Kulurije, fq.63)
Porse mrekullitë e mia i kalojnë një milion mrekulli. (Tedhkireh Shehadetejn, fq.41)

47-Çdo njeri ka mundësi që të ngrihet e të lartësohet, duke arritur në një nivel më të lartë se nivelet e tjera, madje edhe nëse dëshiron që t'ia kaloj Muhamedit të dërguarit të Allahut mundet që ai t'ia kalojë. (Ditët e birit të Kadjanit, pasardhësi i tij i dytë. Botuar dhe shpërndarë në “El Fadl” 17 Korrik 1922)

48-Unë jam dërguar nga Zoti im me gjithë forcën, mbarësinë dhe krenarinë. Dhe kjo këmba ime ka vulosur çdo lartësi. Kini frikë Allahun o ju djelmoha! Më njihni dhe mu bindni dhe mos vdisni të pa bindur, sepse koha u afrua dhe erdhi momenti që çdo njeri të jap llogari dhe të shpërblehet. (Hutbetul Ilhamije, fq.70)

49-Mos më krahasoni me asnjë dhe asnjë mos e krahasoni me mua. Mos e shkatërroni veten tuaj me dyshime, sepse unë jam një bërthamë pa lëvozhg²⁰ dhe një shpirt që s'ka trup me vete dhe një diell që nuk e mbulon tymi i oxhakut. Kërkoni të gjeni ndonjë si unë e s'keni për të gjetur edhe sikur me qiri ta kërkoni. (Hutbetul Ilhamije, fq.51,52)

¹⁸ Në një nga hadithet e H..Muhamedit (alejhi selam) thuhet: Profeti (alejhi selam) tha: “Shembulli im dhe i profetëve është i ngjashëm me një pallat të ndërtuar mjaft bukur por në të u la bosh vendi i një tulle. Njerëzit që e vizitonin atë habiteshin me bukurinë e ndërtimit përveç atij vendi të asaj tulle. Kështu që unë isha ai që zuri vendin e tullës. me mua u përfundua ndërtesa dhe me mua u mbyll radha e profetëve.” Trs. Buhari dhe Muslim.

¹⁹ Këto janë disa prej vargjeve të cilat i recitoi para Kadjanit një prej ithtarëve të tij. Kjo gjë kaq shumë e gëzoi Kadjanin sa që e mirëpriti dhe dha urdhër të botohen këto fjalë në gazetën e tyre “Bedr” 25 Tetor 1906.

²⁰ D.mth. figuracion që nënkupton gjërat esenciale dhe ato sekondare. (sh.përkth)

KADJANI E CILËSON VETEN SI ZOT DHE ME CILËSITË E TIJ

1-Më është dhënë vetia e shfarosjes dhe e ringjalljes nga Zoti veprues. (Hutbetul Ilhamije, fq.55, 56)

2-Kur ti dëshiron ndonjë gjë puna jote është t'i thuash asaj: Bëhu! dhe ajo është e bërë.²¹ (Tedhkireh, fq.525,656,826, dhe Hakikatul Uahj, fq.105)

3-Ti je për Mua në pozitën e njësimi tim (teuhidit) dhe unitetit tim. (Anxhame Atihim, fq.51)

4-Ti je prej Meje dhe Unë jam prej teje. Prezenca jote është prezenca Ime. (Tedhkireh, fq.650,700)

5-Ti je për mua në pozitën e djalit Tim. (Hakikatul Uahj, fq.86)

6-Më dëgjo o biri im! (El-Bushra, v.1.fq.49)

7-Ti je prej ujit tonë e ndërsa ata prej falsitetit. (Anxhame Atihim, fq.55)

8-Toka dhe qielli me ty janë sikurse me Mua. (Anxhame Atem, fq.52)

9-O Ahmed! Emri yt është i plotë e ndërsa i Imi jo. (Enxhuman Atem, fq.52)

10- Allahu ty të falënderon që nga Arshi i Tij. Allahu ty të falënderon dhe vjen drejt teje. (Anxhame Atem, fq.55)

11-Në ëndërr pashë vetë Allahun dhe u binda ndërkohë se unë isha vetë Ai... dhe ndërkohë që unë gjendesha në këtë gjendje thashë: Ne duam një rregull të ri, një tokë të re, një qiell të ri. Kështu që krijova qiejt dhe tokën, së pari në një pamje të përgjithshme pa rregull dhe të pashkoqur. Më pas e shkoqa dhe e sistemova çdo gjë në vendin e drejtë. E ndjeva veten gjatë gjithë krijimit si i mundshëm për gjithçka. Më pas krijova dynjanë dhe thashë: 'Ne e kemi zbukuruar qiellin e dynjasë me ndriçues'²² e më pas thash: tani do ta krijojmë njeriun prej balte...etj. (Ainet Kemalât Islam, fq.564,565)

²¹ Plagjarizëm i shformuar në veten e dytë i marrë nga fjalët e Allahut, surja Jasin: 82)

²² Plagjarizëm shprehimor nga surja Mulk:5. (sh.përkth)

TEUHIDI SIPAS KADJANIT

1-Allahu më tha: Unë falem dhe agjëroj, rri zgjuar por edhe fle. (Tedhkireh,fq.474, Bushra,v.2.fq.79)

2-Allahu i madhëruar tha: Unë me të dërguarin përgjigjem, them atë që është e saktë por edhe gaboj dhe Unë me të dërguarin shkoj. (Bushra,v.2 fq.79)

3-Unë gjatë zbulesës pashë sikur i paraqita Allahut shumë letra, që t'i firmoste dhe të m'i aprovonte kërkesat që i propozova. Pashë se Allahu e vuri firmën mbi letra me një bojë të kuqe. Gjatë zbulesës me mua ishte edhe një nga ithtarët e mi që i thonë Abdullah. Më pas Zoti e ngriti penën dhe prej saj pikuan disa pika të kuqe boje, që ranë mbi rrobat e mia dhe rrobat e dishepullit tim Abdullah. Kur mbaroi zbulesa pashë me të vërtetë se rrobat e mia dhe të Abdullahut ishin bërë me bojë të kuqe. Megjithëse ne s'kishim ndonjë ngjyrë të kuqe aty! Edhe sot e kësaj dite ato rroba gjenden tek ithtari im Abdullah. (Terjak El-kulub , fq.62, 63, Hakikatul Uahj , fq.255)

4-Allahu mu drejtua duke më thënë: Dëgjo këtu o biri im! (El-bushra v.fq.49)

5-O Hënë! O Diell! Ti je prej meje dhe unë jam prej teje. (Hakikatul Uahj, fq. 74)

6-Allahu ka zbritur në mua dhe unë jam ai që ndërmjetësoj mes Tij dhe gjithë krijesave. (Kitabul Beriye, fq.76)

7-Mua më është shpallur: Ne të përgëzojmë ty me Gulamin, treguesi i së vërtetës dhe i lartësisë, i tillë sikur vetë Allahu të kishte zbritur prej qiellit. (Elistifta, Hakikatul Uahj, fq.85)

8-Zoti ynë është i fildishtë. (Tedhkireh, fq.105)

BESIMI I KADJANIT PËR SHPALLJEN, PROFETËSINË DHE MBYLLJEN E SAJ

1-Betohem për Allahun, që ka në dorën e Tij shpirtin tim se, Ai është që më dërgoi dhe më quajti Profet. Ai më thirri si Mesihu i premtuar dhe për të treguar vërtetësinë e thirrjes time zbriti fakte numri i të cilave arriti në 300'000 argumente. (Hakiakatul Uahj, fq.68)

2-Ai është Hyji i vërtetë, i cili dërgoi profetin e tij në Kadjan. Allahu e ruan Kadjanin dhe e mbron atë nga murtaja edhe sikur të zgjasë shtatëdhjetë vjet. Sepse Kadjanin është banesa e të dërguarit të Tij. Pra edhe në këtë ka një provë për njerëzit. (Dafiul Bela, fq.10, 11)

3-Allahu ka zbritur për të vërtetuar mesazhin tim aq fakte dhe prova sa që po tu ishin shpërndarë njëmijë profetëve do të mjaftonte për vërtetimin e mesazheve të tyre. Porse shejtanët e njerëzve nuk e besojnë këtë. (Gishmete (ajn) El-marife, fq.317)

4-Prej mirësive të Allahut është që të vijnë profetët dhe të mos ndërpritet zinxhiri i tyre. Ky është ligji i Zotit dhe as që do të mund ta ndalni. (Përmbledhje nga ligjëratat e Sejalkutit, fq.22)

5-Xhibrili erdhi tek unë dhe më zgjodhi, ai duke rrotulluar gishtin e tij ma bëri me shenjë se Allahu të ruan ty nga armiqtë. (Meuahib Er-rahman, fq.22)

6-Për Zotin e madh! Unë i besoj shpalljes time ashtu siç i besoj Kuranit dhe gjithë librave që kanë zbritur nga qielli. Unë besoj se ato fjalë që më zbritën mua kanë zbritur nga Allahu ashtu siç besoj se Kurani ka zbritur prej Tij. (Hakiatul Uahj, fq.211)

7-Kuptojeni pra se ç'është sheriat, sheriat nuk është gjë tjetër veçse një tregues që urdhëron dhe ndalon. Kushdo që e bën këtë dhe vendos për popullin e tij një ligj ai nuk është gjë tjetër veçse një ligjvënës. Unë pra jam vënës i shariatit, sepse mua më shpallen urdhëresa dhe ndalesa dhe aspak nuk është e nevojshme që një shariat të përbëhet nga ligje të reja, sepse çfarë ka në Kuran prej tyre janë edhe në Teurat. Këtë gjë e tregon Zoti kur thotë: ***“Me të vërtetë që kjo është edhe në shkrimet e para, në shkrimet e Ibrahimit dhe Musait.”*** Suretu Ala:18-19. (Erbein, fq.7. nr.7)

8-E unë nuk jam veçse si Kurani. (Tedhkire, fq.668)

BESIMI I KADJANIT RRETH ISAIT, MERJEMES, MEHDIT, DEXHALIT, DABES DHE JEXHUXHËVE E MAXHUXHËVE

1-Unë jam Mesihu dhe me të vërtetën eci dhe thërras...Isai vdiq dhe nuk jeton sikur ju. (Tuhefetu En-nedue, fq.1)

2-Përsa i përket zbritjes së Isait nga qielli e kemi vërtetuar falsitetin e tij në librin tonë: “El-hamame”, në të cilin arritëm në përfundimin se në Kuran nuk gjejmë veçse vdekjen e tij. (Nurul Hak, fq.51.)

3-Çështja e zbritjes së Isait, profetit të Allahut, ka qenë një trillim i krishterë. Ndërsa Kurani e bën atë të vdekur dhe e rendit atë në radhën e të vdekurve.²³ (Hutbetul Ilhamije, fq.4)

4-Besimi në kthimin e Isait dhe se ai vazhdon të jetojë nuk ka qenë gjë tjetër veçse një nga sajemat e të krishterëve dhe trillimet e tyre...ata muslimanë që kanë menduar se Isai do të zbresë prej qiellit nuk e kanë ndjekur të vërtetën, porse në luginën e humbjes ata janë duke u sorollatur.²⁴ (Hutbetul Ilhamije, fq.6)

5-Është sjellje e paedukatë të thuash se Isai nuk vdiq. Ky është një shirk i madh i cili i bren të mirat dhe lë mbeturinat. Ai vdiq ashtu sikurse vëllezërit e tij dhe ndërroi jetë si bashkëkohësit

²³ E ndërsa Allahu na informon ne në Kuran se ai nuk u kryqëzua dhe as vdiq, por atë Ai e ngriti lart për ta rikthyer edhe njëherë në prag të Kiametit. Shih Kurani. 4:158 dhe 43:61. (sh.përkth)

²⁴ O ju kadjanijë! Cili është gjykimi juaj, nën dritën e këtyre shprehjeve, për të gjithë ata musliman që vdiqën me këtë besim që nga shekulli i parë i hixhretit e deri në këtë shekull, e numri i tyre është gati i pa llogaritshëm?!

Kadajni shprehet: “Unë e di se ky besim i gabuar është përhapur në një kohë të vonshme, pas vdekjes së profetit tonë (alejhi selam). Shumë prej evlijave dhe njerëzve të mirë kanë vdekur me këtë besim. (Shih për këtë librin e tij “Cili është dallimi ndërmjet një ahmediu dhe dikujt tjetër” fq.3) Ai arrin gjeri atje sa të thotë: “Disa prej sahabeve, që s’kishin as pikën e të kuptuarit, por ishin njerëz të trashë, siç është shembulli i Ebu Hurejres, i cili ishte një njeri i trashë dhe nuk kuptonte gjerat mirë. (Zoti na ruajt nga këto kufre) E pra të tillë njerëz besonin se Isai (alejhi selam) ishte i gjallë dhe se ai do të zbresë nga qielli. (I’xhazul Ahmedij, fq.22). A mos vallë i gjithë ky numër i madh njerëzish madje dhe prej sahabeve -Allahu qoftë i kënaqur prej tyre- që të gjithë ata nuk ndoqën të vërtetën, por ishin në humbje?! Mos vallë këta njerëz qenkan prej banorëve të zjarrit?! Allahu na ruajt!

e tij, ndërsa besimi se ai jeton është futur në radhët e muslimanëve nga feja e krishterë.²⁵ (Damimet Hakikat El-uahj, El-istifta, fq.39)

6-Nuk ka ndonjë ndryshim mes fejesës dhe martesës tek afganët, ashtu sikurse edhe tek çifutët dhe nuk është aspak e paturpshme për vajzat, që të takohen e përzihen me të fejuarit e tyre, siç na e tregojnë këtë gjë edhe ecejaket që kishte e ndershmja (Merjem) me të fejuarin e saj (Jozef), shëtitjet që bënte me të jashtë shtëpisë para martesës. Kjo është një dëshmi e vërtetë për këtë çështje. (Ejam Es-sulh, fq.65)

7-Merjemja u zotua për hir të tempullit se do t'i shërbente shtëpisë së shenjtë gjithmonë dhe nuk do të martohet me asnjë gjatë gjithë jetës së saj. Porse mbasi u bë e qartë shtatzënia e saj në muajin e gjashtë apo të shtatë martohet me një marangoz, që e kishte emrin Jozef, ndërkohë që ajo ishte shtatzënë. Mbas një muaji ose dy të martesës lindi nga barku i Merjemes një fëmijë i cili quhet me emrin Isa dhe Jezus. (Geshmehu Mesih, fq.17,18)²⁶

8-Isai i biri i Merjemes (alejhi selam) punoi si marangoz për një periudhë 22-vjeçare bashkë me të atin e tij Jozefin. (Izalet Euham, fq.125)

9-Isai ka pasur katër vëllezër dhe motra të vërtetë. Që të gjithë ishin nga një babë dhe një nënë, pra që të gjithë ishin fëmijët e Jozefit dhe Merjemes. (Sefinetu Nuh, fq.16)

10-Ne kemi të drejtë të themi se çështje të tilla, siç është i biri i Merjemes, dexhali dhe gomari i tij e po kështu jexhuxhi dhe mexhuxhi e dabetul-erdi, nuk i është zbuluar e vërteta e tyre origjinale Profetit alejhi selam dhe as esenca e tyre. (Izalet Euham, fq.282)

11-Për sa i përket dexhalit, dëgjoni tua bëj të qartë, nga vetë frymëzimi im i kulluar. O ju të nderuar! Mua më është zbuluar se qenia e dexhalit nuk është një person i caktuar, porse një njësi e llojit (të keq). Kjo do të thotë bashkim i mendimeve të llojit dexhalian, ashtu siç kuptohet edhe nga vetë fjala dexhal (arabisht: mashtrues, demagog) e pra në këtë emër ka shenja për ata që mendojnë. Qëllimi me fjalën dexhal nuk është gjë tjetër veçse një zinxhir ngjarjesh me drejtime dexhaliane njëra më e madhe se tjetra.²⁷ (Ainet Kemal Islam, fq.554)

12-Me dexhalin nuk kihet për qëllim veçse populli i krishterë ndërsa gomari i dexhalit është treni të cilin e kanë shpikur të krishterët. (Izalet Euham, fq.279,297,298)

13-Qëllimi me daben tek fjala e Allahut: **“dhe nxorëm për ta një kafshë nga toka”** d.m.th. dijetarët sipërfaqësorë, pra xhemati i teologëve. (Izalet Euham, fq.209)

14-Qëllimi me daben janë dijetarët e këqij. (Hamamet El-bushra, fq.105)

15-Qëllimi me daben janë mikrobet e murtajës. (Nuzulul Mesih, fq.38)

²⁵ Cili është gjykimi juaj për Kadjanin? Ai dikur besonte se Isai (alejhi selam) ishte në qiell, i gjallë, dhe se do të zbrësë pranë Kiametit dhe për këtë argumentohej me ajetet e Kuranit. Kjo derisa mbushi moshën 52 vjeç ku më pas e ndryshoi këtë besim mbas kësaj kohe kaq të gjatë me gjithë ‘shpalljen hyjnore’ që i vinte pa ndërprerje! Shih për këtë librin e tij ‘Argumentet Ahmediane’ fq.458, 456, dhe ‘Mrekullia Ahmediane’ fq.9. A nuk është ky njeri me këto fjalë që thotë mushriku më i madh ? Cila është përgjigja juaj?

²⁶ Ku bazohet Kadjani në këto të dhëna?! Te burimet joautentike për jetën e Isait?!

²⁷ Për fat të keq ka pasur muslimanë që me besim të dobët në profecitë e H.Muhamedit (alejhi selam) e kanë mohuar ekzistencën materiale të dexhalit, duke e interpretuar atë në mënyrë figurative, të ndikuar edhe nga filozofit e huaja joislame. Dexhalin nuk e mohon kush tjetër veçse një njeri i humbur që ka nevojë të rigjeneroj besimin e tij.(sh.pëkth)

16-Për sa i përket haditheve për ardhjen e Mehdit, ti duhet ta dish se ato që të gjitha janë të dobëta e të kritikueshme, kontradiktore mes vetes. Saqë ka ardhur një hadith tek Ibn Maxha dhe në libra të tjerë se s'ka Mehdi veçse biri i Merjemes,²⁸ e si atëherë mund të mbështetesh tek këto hadithe.²⁹ (Hamamet El-bushra, fq.110)

17-Qëllimi me Jexhuxhët dhe Maxhuxhët është Rusia dhe Anglia. (Shehadetul Kuran,.fq.25)

FYERJE DHE SHPIFJE NDAJ ISAIT (ALEJHI SELAM)

1-Allahu dërgoi prej këtij umeti Mesihun, i cili është më madhështor se Mesihu i parë. Pasha Allahun në dorë të cilit është shpirti im, nëse Isa i biri i Merjemes do të ishte në këtë kohë në të cilën unë jetoj, nuk do mund të bënte atë që unë bëj dhe as që do të kishte mundësi të prezantonte argumente apo fakte që unë i shfaq. (Hakikat El-uahj,fq.148)

2- Mesihu pinte verë, ndoshta se ai ishte i sëmurë apo për shkak të zakonit të tij të vjetër. (Sefinet Nuh,fq. 65)

3-Unë jam i mendimit se Mesihu nuk i shmangej pirjes së verës. (Review of Religions, v.1. fq.123 viti.1903)

4-Mesihu nuk mund të thoshte për veten e vet se ai ishte njeri i mirë, kjo sepse njerëzit e njihnin se ai ishte pijanec dhe me moral të prishur. (Sit beixin Hashije fq.182)

5- Familja e Isait ishte e pastër dhe e ndershme! Tre gjyshet e tij nga i ati dhe e ëma kishin qenë të shturura, lavire. Dhe nga ky 'gjak i pastër' erdhi në ekzistencë Isai! Ai anonte nga prostitutat dhe shoqëria me to, ndoshta kjo për arsyen që e përmendëm më sipër. Nuk është aspak e lejueshme për një njeri të devotshëm që kokën e tij ta prekë një vajzë e përdalë e t'ia parfumojë kryet me një pasuri që e ka nxjerrë me haram. Kuptoni pra o njerëz se çfarë morali ka pas ky njeri.³⁰ (Damimet Anxhame Atem, fq.7)

DOKTRINA E KADJANIT PËR FSHATIN NË TË CILIN AI LINDI

1-S'ka dyshim se toka e Kadjanit meritonte nderimin, ajo është prej krijesave të para dhe tokë e shenjtë. (Deru Themin, fq 52)

2- Kur'ani fisnik ka përmendur emrat e tre vendbanimeve me respekt dhe nderim Meka, Medina dhe Kadiani. (Izalet Euham, fq.34)

3- Xhamia El-Aksa është xhamia që ndërtoi Mesihu i premtuar në Kadian. (Hutbetul Ilhamije, fq.25)

²⁸ Hadith tepër i dobët, shih Silsiletu el-ehadithu daife nr.77

²⁹ Çudi me këtë njeri e bën veten kompetent edhe në fushën e hadithit dhe saktëson atë që do e dobëson atë që si shkon për shtat dhe e gjithë kjo pa u mbështetur aspak në fjalët e dijetarëve kompetent në këtë fushë, të cilët thonë se hadithet për ardhjen e Mehdit arrijnë në gradën Teatur kuptimor dhe është e pa mundur që shfaqja e Mehdit mos të jetë një paralajmërim profetik. Madje Kadjani me këto fjalë kundërshton vetveten, pasi shkatërron gjithë themelin mbi të cilin ai ngrii thirrjen e tij, fillimisht se ai ishte Mehdi i pritur. Atëherë nuk tregon kjo se ai ishte vërtetë një shejtan-budalla. (sh.përkth)

³⁰ Shikoni me ç'ironi dhe fjalë poshtëruese flet ky sharlatan, dexhal për një nga profetët më të nderuar të Allahut Isain (alejhi selam)! E pretendon pastaj të jetë Mesihu apo Mehdiu i pritur?! Zoti na ruajt nga lajthitjet! (sh.përkth)

4-Kadjani është Um Ul-Kurra (nëna e fshatrave)³¹ ai i cili ndahet prej saj prishet dhe shkatërrohet. Ruajuni pra që të mos bëheni prej të shkatërruarve. Frytet e Mekës dhe të Medines kanë shteruar, por frytet e Kadjanit vazhdojnë të jenë të freskëta. (Hakikatu er-ruja, fq.46)

5-Kadjani është kërthiza e botës dhe ai është Um Ul-Kurra, kështu që është e pamundur që të arrihet ndonjë përfitim pa këtë vend të shenjtëruar. (Fjala nga hutbeja e xhumasë që mbajti Mahmud Ahmed i biri i Kadjanit e publikuar në gazetën e tyre “El-Fadl” më 3 Janar 1925)

6-Allahu i ka shenjtëruar këto vende: Mekën, Medinen dhe Kadjanin. Ai i zgjodhi këto të tria për të prezantuar madhësinë e Tij. (Gazeta “El-Fadl” 3 Shtator 1935)

7-Fjala e Allahut: *“dhe kush hyn në të është i sigurt”* i përkon xhamisë së Kadjanit. Emri i dytë i Kadjanit është ‘Darul Eman’ (vendi i sigurisë) (Berahin El-Ahmedije, v.4 fq.518 shih dhe Teblig Er-risaleh, v.6 fq.152)

8-Ai i cili viziton tyrben e bardhë të Mesihut të premtuar (në Kadjan), merr pjesë në mbarësitë dhe bekimet që mbart edhe kubja e gjelbër e Profetit në Medine.³² Sa pa fat është ai njeri që e privon veten nga kjo gjë. Nga kjo kënaqësi në Haxhin e madh në Kadjan. (Gazeta “El-Fadl” 18 Dhjetor 1922)

9-Ç’është Kadjani? Kadjani është një shenjë e ndritshme prej shenjave të madhërisë së Allahut dhe plotfuqishmërisë së tij, ashtu siç na tha hirësia e tij Mesihu i premtuar (Kadjani). Ajo gjithashtu është qendra e Kalifatit për të dërguarin e Allahut, banesa e Mesihut, vendlindja dhe vendvarrimi i tij. Në këtë fshat gjendet një shtëpi në të cilën banonte shpëtimtari i botës, vrasësi i dexhalit, thyesi i kryqit dhe shfaqësi i fesë Islame mbi të gjitha fetë. (Gazeta “El-Fadl” 13 Dhjetor 1939)

10-Po ju them juve sinqerisht, se, Allahu më informoi që toka e Kadjanit ka mbarësi dhe në të zbresin po të njëjtat bekime të cilat zbresin në Mekë dhe në Medine. (Thënie e birit të Kadjanit, Gazeta “El-Fadl” 10 Dhjetor 1932)

11-Kadjani është burimi i mirësive të Zotit dhe mbarësive të Tij. Në asnjë vend tjetër nuk zbresin këto mirësi ashtu siç zbresin në Kadjan. Gulam Ahmed Kadjani pat thënë se, ai i cili nuk vjen në Kadjan frikësohem për besimin e tij. (Enuar Hilafet, fq.117, i të birirt të Kadjanit)

12-Nëse toka e arabëve krenohet me tokën e Haremit (Mekën) atëherë toka e joarabëve krenohet me tokën e Kadjanit. (Gazeta “El-Fadl” 25 Shtator 1932)

³¹ Ky është një nga emërtimet që Allahu i ka dhënë Mekës, për ta nderuar atë, por Kadjani, me paturpësinë më të madhe mbiquan vendlindjen e tij me të! (sh.përkth)

³² Kjo kube mbi varrin e Profetit (alejhi selam) është një ndërtim i ngritur në kohë të vonshme. Për qindra vjet ajo nuk ka ekzistuar dhe as që ka ndonjë pikë shenjtërie në të. (sh.përkth)

DOKTRINA E KADJANIT PËR HAXHIN

1-Konferenca jonë vjetore është Haxhi. Allahu zgjodhi vend për këtë Haxh Kadjanin...në të janë të ndaluara marrëdhëniet intime me gratë, mëkatet dhe polemikat e pa vlera. (Berekat El-hilafet, fq.5,8 I birit të Kadjanit)

2-Nuk ka Islam pa besim tek Gulam Kadjani, ashtu siç nuk ka Haxh pa marrë pjesë në konferencën Kadjanite. Kjo sepse Haxhi sot në Mekë nuk e kryen më misionin e tij dhe nuk e arrin qëllimin e tij. (Gazeta Kadjaniste “Bigam Sulh” 19 Prill 1933)

3-Vetëm qëndrimi në Kadjan është shumë më i mirë sesa Haxhi fakultativ. (Ainet Kemalat Islam, fq.352)

KADJANI DHE QEVERIA KOLONIZATORE ANGLEZE SHËRBIMET DHE MBËSHTETJA E TIJ NDAJ KËSAJ QEVERIE

Pesëdhjetë arka:

1-E harxhova pjesën më të madhe të jetës time në mbështetje të qeverisë Angleze dhe në ndihmë të saj. Kam shkruar për ndalimin e Xhihadit dhe domosdoshmërinë e bindjes ndaj pushtetit anglez, libra, lajmërimi dhe shkrime saqë po të mblidheshin të gjitha bashkë do të ishin mbushur pesëdhjetë arka. Të gjitha këto libra i kam shpërndarë në vendet arabe, Egjipt, Sham dhe Turqi. Pikësynimi im gjithmonë ka qenë që, myslimanët ta lënë të qetë këtë qeveri dhe të fshihen nga zemrat e tyre historitë e Mehdit gjakatar dhe Mesihut vrasës e po ashtu edhe ligjet e Sheriatit të cilat ngjallin tek ta ndjenjën e Xhihadit dhe prishin zemrat e budallenjve. (Terjak El-kulub, fq 25 e Kadjanit)

Pesëdhjetë mijë libra dhe mesazhe:

2-Kam shpërndarë pesëdhjetë mijë libra dhe mesazhe në këtë vend dhe në vendet islame, për të treguar se qeveria angleze është qeveria e mirësisë dhe e nderit për myslimanët, prandaj është detyrë për çdo mysliman që t'i bindet kësaj qeverie me një bindje të sinqertë. Këto libra i kam shkruar në gjuhët perse, arabe, dhe urdu, duke i shpërndarë ato nëpër vendet e botës islame, saqë kanë mbërritur dhe shpërndarë deri dhe në dy vendet e shenjta Mekë dhe Medine. Po kështu edhe në Stamboll, në vendet e Shamit, Egjipt dhe Afganistan. Dhe si rezultat mijëra njerëz e flakën tutje idenë e Xhihadit, që nuk ishte gjë tjetër veçse një propagandë e dijetarëve të ngurtë.

Unë krenohem me këtë rezultat. Askush prej myslimanëve në Indi nuk ka mundësi që të rivalizohet me mua në këtë pikë. (Sitaret Kajsareh, fq.7 Shkresë dërguar nga Kadjani mbretëreshës së Anglisë Viktoria)

Pesëdhjetë kuaj dhe kalorës:

3-Babai im Gulam Murteda ishte prej atyre që kishin lidhje të mira dhe marrëdhënie të afërta me qeverinë angleze. Ai ishte një ndihmës i qeverisë kur bashkatdhetarët dhe bashkëfetarët e tij Indianë u ngritën kundra qeverisë në vitin 1857, duke u dhënë atyre një ndihmë mjaft të vlefshme. Madje dërgoi edhe pesëdhjetë ushtarë dhe pesëdhjetë kuaj nga ana e tij duke i shërbyer kështu qeverisë mbi mundësitë e tij. (Tuhfetu Kajserie, fq. 26)

Jam duke luftuar me gjuhën dhe me penën time prej më se 60 vjetësh:

4-Kam që në moshë të re dhe sot po i afrohem të gjashtëdhjetave që, luftoj me gjuhë dhe me penën time, për të mbjellë sinqeritetin në zemrat e myslimanëve ndaj qeverisë angleze; ta duan dhe respektojnë atë dhe të hedhim tutje idenë e Xhihadit, me të cilën janë lidhur disa injorant prej tyre dhe që i pengon ata nga sinqeriteti ndaj kësaj qeverie. Jam i mendimit se shkrimet e mia kanë dhënë rezultat në zemrat e myslimanëve dhe kanë ndikuar në ndryshimin e qindra mijërave prej tyre. (Tebliğ Risale, v.7 fq. 10)

Unë jam prej shërbëtorëve të saj:

5-Nuk është e panjohur për këtë shtet të bekuar se, unë jam prej shërbëtorëve dhe këshilltarëve të tij dhe propaganduesi i të mirave të tij, qysh herët. Ne çdo herë kemi qenë ndaj këtij shteti me zemër të sinqertë. Babai im ka qenë i afërt me këtë shtet dhe me marrëdhënie të mira. Po ashtu dhe ne kemi dorë në shërbim të këtij shteti dhe nuk mendojmë se mund ta harroj këtë ndonjëherë. Im atë Mirza Gulam Murteda, i biri i Mirza Ata Muhamed El-kadjani, ishte këshilltarë për atë shtet dhe mik i tij. E gjithë kjo buronte nga bujaria për të fuqishmin dhe shteti e dinte mirë këtë. Nuk kemi qenë prej hipokritëve, saqë edhe njerëzit që të gjithë ishin të bindur për sinqeritetin tonë. Për pushtetarët u bë e qartë, nga të gjithë përfaqësuesit e shtetit të cilët patën qëndruar mes nesh dhe panë, se si ne jetuam para syve të tyre dhe se si konkurrionin me të tjerët për tu shërbyer atyre. (Nur El hak, pjesa e parë fq.27, 28)

Unë jam kështjellë dhe mburojë për këtë shtet:

6-Shkrimet e mia në gjuhën arabe nuk kanë qenë veçse për qëllime të tilla të mëdha. Shoqëritë arabe nuk do të mbeteshin larg nga librat e mi saqë unë do të shikoja gjurmët e ndikimit të atyre librave. Disa do të vinin të më takonin, disa të tjerë lidhën korrespondencë, disa më korrigjonin dhe disa ranë dakord të më shërbenin si udhëzues. Unë kam harxhuar një kohë të gjatë duke u marrë me këto shkrime saqë më kanë kaluar më se njëmbëdhjetë vjet në këtë punë propagandistike. Nuk kam përtuar ndonjëherë prandaj më takon që të pretendoj se jam i vetëm në këto shërbime. Jam i vetmi që kam dhënë këtë mbështetje dhe më takon të them se unë kam qenë mburojë dhe kështjellë për të dhe ruajtësi i saj nga rreziqet. Zoti im më përgëzoi dhe më tha: *“Por Allahu nuk do t’i ndëshkonte ata kur ti je mes tyre”*³³

Ky shtet nuk ka për të gjetur një njeri të ngjashëm me mua në ndihmë dhe shërbim të tij. Shteti do ta mësojë këtë gjë nëse është prej atyre që nxjerrin mësim. (Nur El-Hak, pjesa e parë fq.33,34)

Shteti më mbrojti mua dhe xhematin tim

7-Unë e di se Allahu i madhëruar e bëri qeverinë britanike mburojë dhe vendstrehim për mua dhe xhematin tim, dhe kjo qe një mirësi e tij e veçantë. Kjo siguri që ne patëm nën hijen e kësaj qeverie nuk mund të arrihet as në Mekën e nderuar dhe as në Medinen e ndritshme. (Terjak Kulub, fq.26)

Kjo pemë u mboll me duart e qeverisë angleze

8-Prej qeverisë shpresohet që këtë familje, e cila është filiz i vetë anglezëve dhe shpikje e tyre, të trajtohet në veçanti me seriozitet, krenari, plotësim të kërkesave dhe kujdestari. Prej njerëzve të kësaj qeverie kërkohet që të sillen me mua dhe me xhematin tim me një butësi të veçantë dhe kujdes të lartë, sepse ne asnjëherë nuk jemi vonuar të sakrifikojmë për hirin tuaj as veten dhe as gjakun tonë. (Tebliğ Risalat, v.7 fq.19)

Besimi dhe rruga ime

³³ Ajet i shkëputur nga surja Enfalë:33 drejtuar Profetit tonë Muamedit (alejhi selam) (sh.përkth)

9-Është bërë më se e qartë nga ligjëratat e mia të pandërprera, gjatë gjithë këtyre 17 vjetëve se, tek unë ekziston sinqeriteti për shtetin anglez që nga thellësia e zemrës, dhe shpirti i bindjes ndaj qeverisë. Kjo është madje doktrina, të cilën unë e futa në kushtet e betimit, për atë që më pason dhe më simpatizon. Për këtë doktrinë kam folur mjaft hapur në pikën e katërt të mesazhit që flet për kushtet e betimit dhe që u shpërndahet dashamirësve dhe ndjekësve të mi. (Ishtihar Auxhib Idh'har, bashkangjitur me librin El-berije, fq.9)

10-Besimi dhe rruga ime të cilën unë vazhdimisht e përsëris është se, Islami përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë është bindja ndaj Allahut, pjesa e dytë është bindja ndaj qeverisë, e cila vendosi sigurinë dhe na futi nën hijen e saj, duke na mbrojtur nga të padrejtët, e ajo është qeveria britanike. (Shehadetu El-kuran, fq.86)

KADAJNI DHE XHIHADI

1-Allahu e uli ashpërsinë e Xhihadit, pra të luftës në rrugë të Allahut në mënyrë të shkallëzuar. Në kohën e Musait vriteshin edhe fëmijët, ndërsa në kohën e Muhamedit (alejhi selam) u anulua vrasja e fëmijëve, pleqve dhe grave, ndërsa në kohën time Xhihadi u anulua plotësisht. (Erbein, n.4 fq. 15)

2-Sot u anulua ligji i luftës me shpatë, nuk ka më Xhihad pas sot e kësaj dite. Kushdo që do të ngrejë pas kësaj armën mbi qafirët dhe e quan veten luftëtarë do të jetë kundërshtarë i të dërguarit të Allahut, i cili shpalli para 13 shekujve anulimin e Xhihadit në kohën e Mesihut të premtuar. S'ka më Xhihad tani pas shfaqjes time. Ne ngremë flamurin e paqes dhe të sigurisë. (Hutbetul Ilhamije, fq.28 ,Teblig Risale v.9 fq.47)

3-Lëreni tashmë idenë e Xhihadit, sepse lufta për hir të fesë është bërë haram. Tashmë erdhi prijësi dhe Mesihu, zbriti drita prej qiellit, prandaj s'ka Xhihad madje ai që lufton në rrugë të Allahut tashmë e tutje do të jetë armik i Zotit dhe mohues i profetit tek i cili ai beson. (Damimet Tuhfet Kulurije, fq)

4-Është detyrë për qeverinë angleze që të njoh gjendjen e kadjanive, sepse prijësi jonë ka harxhuar 22 vjet nga jeta e tij për të mësuar njerëzit se Xhihadi është haram, haram i prerë. Ai nuk u mjaftua me përhapjen e këtyre mësimëve vetëm në Indi, por i përhap ato gjithashtu edhe në vendet islame, mes arabëve, në Sham, Afganistan ...etj. (Shkruar nga drejtori i revistët kadjaniste "Review of religions" nr.25 v.1904 Muhamed Ali)

5-Ky grup, grupi kadjani nuk ka pushuar ndonjëherë së punuari për të zhdukur këtë doktrinë të pisët, doktrinën e Xhihadit nga zemrat e myslimanëve. (Review of Religions n.5 v.1922)

6-Sekti islamik, të cilin Allahu e vuri nën udhëheqjen time, dallohet nga të tjerët, sepse ai nuk e pranon Xhihadin me shpatë dhe as që rri në pritje të tij. Porse, ky grup i bekuar nuk e lejon atë qoftë fshehtazi qoftë haptazi, por e ndalon atë dhe e bën haram në mënyrë të prerë. (Terjak El-kulub, fq.332)

7-Shumë herë e kam përsëritur në shkrimet e mia se, Kurani nuk jep mësim për Xhihadin, ky ligj ka qenë i veçantë për një kohë të caktuar dhe jo përgjithmonë. Islami është larg veprave (luftarake) që u shfaqen nga mbretërit që erdhën pas kohës profetike, për qëllime vetjake apo gabime trashanike. (Damimet El-Hukumet El-inxhizlije e El-Xhihad, fq10 ,11)

NXJERRJA NGA FEJA E TË GJITHË ATYRE QË NUK BESOJNË TE KADJANI

1-Do të themelohet një xhema dhe Allahu ka për t'i fryrë birit me gojën e Tij për ta mbështetur atë. Mbas këtij zëri do të tërhiqet çdo njeri i lumtur dhe nuk do të mbesë vetëm se të dështuarit, të cilët humbën rrugën duke kundërshtuar të drejtën, për të mbushur kështu Xhehenemin. (Berahin El-Ahmedije, v.5 fq.82)

2-Allahu më frymëzoi se ata që nuk të pasojnë ty dhe nuk hynë në besën tënde, por se mbeten kundërshtarë të tu, ata janë mëkatarë ndaj Allahut dhe të dërguarit të tij dhe banorë të Xhehenemit. (Tedhkireh Mexhmuat Ilhamat, e vetë Kadjanit, fq.342)

3-Të gjithë myslimanët, të cilët nuk hynë në besën e Mesihut të premtuar (Kadjanit), dëgjuan apo nuk dëgjuan për Gulam Ahmedin, që të gjithë janë qafirë dhe jashtë rrethit të Islamit. (Ainet Sadakat, fq 35. i birit të Kadjanit dhe mëkëmbësi i tij i dytë, Mirza Beshirudin Mahmud Ahmed)

MARTESA ME JOKADJANIT KONSIDEROHET KUFER

1-Nuk lejohet për asnjë kadjanit që të martojë vajzën e tij me një jokadjanit, sepse ky është urdhër i Mesihut të premtuar, Kadjanit. Urdhër i prerë. Ai tha se, kushdo që marton vajzën e tij me një jokadjanit, ai do të jetë jashtë xhematit tonë, sado që të pretendojë se është kadjanit. Gjithashtu nuk i takon asnjërit që i përket xhematit tonë të marrë pjesë në këto ceremoni martesore. (Gazeta "El-Fadl" 23 Maj 1931)

2-Lejohet martesë me vajzat e myslimanëve, hindusëve dhe sikhëve, porse nuk lejohet që tu jepen vajzat atyre. (Gazeta "El-Fadl" 18 Shkurt 1930)

3-Ai që ia jep vajzën e tij myslimanëve përzihet nga xhemati dhe konsiderohet kafir. (Gazeta "El-Fadl" 4 Maj 1922)

4-Çështja Nr. 5: Është detyrë për xhematin tonë në këtë kohë që mos t'ia japim vajzat joahmedive. Kushdo që ia jep vajzën një joahmediu, nuk e ka njohur Mesihun e premtuar ashtu siç duhet dhe ai as që e njeh seç është Ahmedizmi. A ka jashtë Ahmedive ndonjë njeri të pa fe (d.m.th. myslimanët) që t'ia japi vajzën e tij një hindusi apo të krishteri?! Për ne joahmeditë janë kafirë, por se ata janë më të mirë se ju në këtë pikë, sepse ata nuk ua japin vajzat e tyre qafirëve, megjithëse edhe ata vetë janë qafirë. Kurse ju duke qenë ahmedij ua jepni vajzat tuaja qafirëve! (d.m.th. myslimanëve) (Melaiketullah, fq.46 i birit të Kadjanit Mirza Beshirudin Mahmud)

NAMAZI MBAS JOKADJANIVE ËSHTË PLOTËSISHT HARAM

1-Ky është medhhebi im i ditur se, nuk lejohet për ju që të faleni mbas një jokadjani, sido që të ndodhë dhe kushdo që të jetë ai, e sa do që ta lavdërojnë atë njerëzit. Ky është pra ligji i Allahut dhe kjo është ajo që Ai dëshiron. Ai që dyshon dhe është i lëkundur është në radhët e përgënjeshtresve. Allahu dëshiron që t'iu dallojë juve nga ata. (Fjala e Kadjanit e shkruar në gazetën “El-hukm” 10 Dhjetor 1904)

2-Allahu më bëri të ditur se, është haram i prerë që të faleni pas atij që nuk më beson mua, apo që është i lëkundur në bindje ndaj meje. Është obligim për ju që të faleni pas një imami që është prej jush, siç tregohet edhe në hadith *“e imami juaj është prej jush”* d.m.th. që kur të zbres Mesihu, për ju është detyrë që të largoheni nga grupet e tjera që pretendojnë të jenë islame dhe të vendosni për imam njërin prej jush. Veproni siç u urdhëruat! A mos doni që tu zhvlerësohen punët dhe ju të mos e kuptoni! (Erbein, v.3 fq. 34 po ashtu edhe në Tuhfetu Kulurije, fq. 27)

3-Nuk i lejohet asnjërit që të falet pas një jokadjani. Njerëzit shumë janë duke e përsëritur këtë pyetje! A lejohet namazi pas tyre apo jo? Unë po ju them, sado që të më pyesni, po them se, nuk lejohet. (Enuar Hilafet, fq.89 i birit të Kadjanit Bashirudin Mahmud Ahmed)

NAMAZI MBAS NJË JO KADJANI NË RAST NEVOJE

Mëkëmbësi i dytë, i biri i Kadjanit Mirza Beshirudin Mahmud Ahmed thotë: Në vitin 1912 shkova në Egjipt dhe prej andej u nisa për në Haxh. Në Xhideh u takova me gjyshin tim nga nëna, kështu që shkuam bashkë për në Mekë. Që në ditën e parë gjatë kohës që ndodheshim në tavaf na zuri namazi, desha që të largohesha, por rrugëkalimet u zunë për shkak të kallaballëkut të madh. Filloi namazi, gjyshi më urdhëroi që të futeshim në namaz, u falëm dhe kur u kthyem në shtëpi thamë: a po falemi për hir të Allahut një namaz që nuk pranohet dhe as që është i rregullt mbas një jokadjani?! U çuam dhe e falëm atë namaz përsëri. Kështu vepronim dhe shpesh herë falehim në shtëpinë tonë. Ndonjëherë vonoheshim derisa të mbaronte namazi me xhemat dhe pastaj falehim me xhematin tonë. Kishte raste që me ne falehim edhe të tjerë jokadjani. Më pas kur u kthyem, njëri prej nesh e pyeti mëkëmbësin e parë, Nuredinin, çfarë të bëjë një kadjani nëse falet mbas një jokadjani? Ai na u përgjigj: nëse e sheh të nevojshme që të falesh mbas një jokadjani, mund të falesh pas tij, por duhet që atë namaz ta përsëritësh përsëri. (Ainet Sadakat, fq. 91. i të birit të Kadjanit)

NUK LEJOHET NAMAZI I XHENAZES PËR MUSLIMANËT E VDEKUR DHE AS PËR FËMIJËT E TYRE

1-A lejohet namazi i xhenazes për fëmijët e myslimanëve? Po ju them: nuk lejohet, ashtu siç nuk lejohet për fëmijët e hindusve dhe të krishterëve, sepse feja e fëmijës është feja e prindërve të tij dhe ai është ndjekës i tyre. (Thënë nga i biri i Kadjanit dhe mëkëmbësi i dytë i tij Bashirudin Mahmud Ahmed në 'Enuar Hilafet' fq. 93)

2-Nëse thuhet: si të veprohet në rast se një kadjani ka shkuar në një vend ku ka vdekur një njeri, të cilit nuk i ka mbërritur thirrja (kadjane)? A i falet xhenazja atij apo jo? Ne i përgjigjemi duke thënë se, nuk njohim veçse atë që shohim dhe ajo çka shohim është se, ai njeri ka vdekur duke mos e njohur të dërguarin e Allahut dhe profetin e Tij (Kadjanin). Prandaj nuk ia falim atij dhe as atij që falet pas myslimanëve apo ka marrëdhënie me ta, sepse ai me këtë veprim ka dalë jashtë Kadjanizmit. (Shkruar nga i biri i Kadjanit Mahmud Ahmed dhe botuar në gazetën e tyre 'El-Fadl' 6 Maj 1910)

3-Kur vdiq djali i madh i Mesihut të premtuar, që quhej Fadl Ahmed dhe që e kishte me gruan e parë, i ati nuk ia fali atij xhenazen, sepse ai nuk i besonte atij dhe atyre që thoshte ai, megjithëse ai i bindej të atit në punët e kësaj bote. (Enuar Hilafet, fq. 91, i birit të Kadjanit Mahmud Ahmed)

4-Kur vdiq Muhamed Ali Xhenah themeluesi i Pakistanit, Dhaferullah Han (kadjanij) nuk ia fali atij xhenazen. Në këtë kohë ai ishte ministër i jashtëm i Pakistanit.

5-Faljet tona janë të veçanta ashtu siç na është ndaluar tu japim vajzat tona për martesë, na është ndaluar gjithashtu tu falim të vdekurve të tyre xhenazen. E ç'mbeti tjetër që të komunikojmë me ta?! Marrëdhëniet ndahen në dy pjesë: fetare dhe jetësore. Lidhja më e madhe fetare janë adhurimet dhe lidhja më e madhe jetësore janë krushqitë. Ne na është bërë haram që të adhurojmë Zotin bashkë dhe të bëjmë krushqi me ta. Nëse do të thoni: si është e mundur atëherë të lejohet marrja e vajzave të tyre?! Po ju them ashtu siç na lejohet të marrim vajzat e të krishterëve. Nëse thoni: pse iu jepni selam atyre? Po ju themi se Profeti (alejhi selam) iu jepte selam çifutëve... ajo çka dua të them është se para nesh qëndron një ndarës që na ndan në çdo aspekt. (Kelimetul –Fasl, fq. 169. e birit të Kadjanit Beshir Ahmed)

PYETJE DREJTUAR KADJANIVE NGA AUTORI I KËTIJ LIBRI

Kadjani mbasi përmend librat të cilat ka shkruar për të vërtetuar vdekjen e Isait birit të Merjemes (alejhi selam) thotë: *“Tek ata libra çdo mysliman shikon me një sy dashamirësie dhe respekti duke përfituar prej lëndës që gjendet në to. Ata i pranojnë dhe i besojnë gjithçka gjendet në to. Ata i pranojnë dhe i besojnë ato ashtu siç i besojnë thirrjes time, përveç atyre që janë **fëmijë laviresh**, të cilëve Allahu ua ka vulosur zemrat dhe nuk më pranojnë.”* (Ainet Kemal Islam, fq.547)

Djali i madh i Kadjanit 'Fadl Ahmed' nuk i besoi të atit dhe as atyre që thoshte ai, saqë kjo e shtyri Kadjanin që të mos ia falte atij xhenazen kur vdiq, siç u përmend edhe pak më parë. Tani lind pyetja: O ju që i besoni Kadjanit! Si qëndron puna e këtij biri 'Fadl Ahmed'?!
Ju lutem na e shpjegoni këtë nën dritën e vendimit të profetit tuaj Kadjan? Nëse ai është pasardhësi i një lavireje atëherë nëna e tij është një prostitute, dhe i ati i tij Kadjan është bashkëshorti i një prostitute! Ç'familje qenka kjo atëherë?! Vërtetë për tu çuditur!

Kadjani kishte sharë dhe ofenduar të gjithë myslimanët, mjaft rëndë, dhe ja tani shohim se si i kthehen ofendimet dhe sharjet familjes së tij! A nuk është kjo një prej çudive të Allahut tamam siç thotë i Madhëruari: “*por dredhia e keqe nuk godet tjetër kë vetëm se atë që e kurdis*” (Sure Fatir:43)

KADJANIT DHE MARRËDHËNIET E TYRE ME IZRAELIN

Ne kemi një qendër dhe një xhami në Haifa (Izrael). Po ashtu kemi një bibliotekë të përgjithshme për lexuesit dhe një librari të veçantë për shitjen e librave si dhe një shkollë. Qendra jonë atje boton një revistë mujore me emrin ‘Bushra’, e cila dërgohet në tridhjetë vende arabe. Po ashtu me ndihmën e kësaj qendre janë përkthyer edhe disa materiale të Mesisë së premtuar, Mirza Gulam Ahmedit, në gjuhën arabe. Para disa kohësh qendrën e vizitoi kryetari i bashkisë së Haifës me të cilin studiuam disa çështje, ku kryebashkiaku tregoi gatishmërinë e tij që të ngrejë për ne një shkollë në Kebabir, në të cilin banojnë një numër i madh i kadjanive. Ashtu siç na premtoi që të na vizitonte përsëri në Kebabir. Pas kësaj vizite ai erdhi përsëri i shoqëruar, këtë radhë me katër personalitete të njohur në Haifa. Ata i pritën atje xhemati ynë bashkë me nxënësit e shkollave, ku edhe u organizua një ceremoni festive, për tu urreuar atyre mirëseardhjen. Para largimit ata lanë një shënim në librin e përshtypjeve, ku shfaqën ndjenjat dhe konsideratat e tyre për ato që panë.

Lexuesve tanë mund t’i jetë bërë e qartë pozita jonë në Izrael, sidomos kur përfaqësuesi ynë Shuhedra Muhamed Sherif dëshironte të kthehej nga Izraeli në Pakistan në vitin 1957. Presidenti i Izraelit kërkoi prej tij që ta vizitonte para nisjes së tij, kështu që misionari përfitoi nga rasti për... hollësitë e vizitës së tij janë përshkuar në gazetatat izraelite, ashtu siç u bë e ditur për këtë gjë edhe në radion izraelite. (Qendrat tona jashtë vendit, fq.79, botuar në Rebu, Pakistan.)

MBYLLJE

E gjithë kjo që paraqitëm para umetit Muhamedan nuk është gjë tjetër veçse besimet, idetë dhe mendimet e Gulam Ahmed Kadjanit. Ato janë një kufër dhe herezi e hapur, janë një rebelim i dukshëm kundra Islamit, nga një renegatë i tillë, i cili del tërësisht jashtë Islamit dhe mohon fenë e H. Muhamedit (alejhi selam). Këto doktrina janë një armiqësi e shpallur kundra fesë tonë. Janë kaq të qarta sa që është e panevojshme të përgatitësh një kundërpërgjigje me fakte dhe argumente për të hedhur poshtë ato; *Fshati që duket s’do kallauz.*

Gjërave të tilla për tu kundërvënë nuk ka nevojë për argumente për një besimtar të devotshëm apo për një dijetar të sinqertë. Ato janë kaq të qarta dhe kaq troç, sa që nuk ekziston fare mundësia e interpretimit. Ai është shprehur mjaft haptazi në këto besime të tij, saqë nuk lë asnjë shteg për interpretime dhe as pak vend për tu luhatur në kufrin e tradhtinë e tij. Këto janë vetëm disa shembuj të doktrinave të tij dhe nuk kam pasur për qëllim që në këtë libër të përfshija gjithçka. Kadjani e ka shpërndarë helmin e kufrin të tij në të gjitha degëzimet e shkrimeve të tij, aq sa çdokush mund të habitet. Dhe do të mjaftonte vetëm një e dhjeta e atij grumbulli të madh (skoriesh) që ai ka thënë e bërë, për ta konsideruar atë qafir. E si i bëhet halli nëse do t’i mblidhnim të gjitha doktrat dhe pallavrat e tij?! Ai pretendoi të ishte Mehdi e më pas një njeri i ngjashëm me Mesihun e më pas vetë Mesihu i premtuar, ashtu siç do të pretendonte pas kësaj se Mesihu vdiq dhe se ai nuk ka për të zbritur në prag të Kiametit. Më pas ai do të arrinte deri

në fyerjen e këtij profeti të madh, me ofendime të tilla nga të cilat të pëlçet zemra nga zemërimi. Ai do të shpifte se gjoja Jozef marangozi ishte babai i tij duke përgënjeshtuar kështu Kuranin. Prej tij do të dalë dhe pretendimi se, Profeti ynë (alejhi selam) nuk është vula e profetëve dhe se pas tij ka profetë të tjerë. Ai gjithashtu pretendoi se ai ishte më i miri nga të gjithë profetët - paqja e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë mbi ta-. Kadjanit thoshte se 'mrekullitë e tij' janë shumë më të mëdha në numër dhe në lartësi sesa mrekullitë e Profetit tonë Muhamedit (alejhi selam), ai pretendoi se Xhahadi dhe Haxhi janë anuluar, pretendoi se qeveria Britanike është hija e Zotit mbi tokë, ashtu siç e pranoi se Kadjanizmi është një pemë farën e së cilës e hodhën vetë britanikët. Ai do të akuzojë të gjithë ata që nuk i besuan atij dhe profecisë së tij të rreme se janë pasardhës prostitutash! Shto këtu edhe gjithë ato kufre, herezi, lajthitje, injorancë dhe afetarizëm që u bënë të qarta në faqet e mëparshme të cilat mbushin kupën e tij. A nuk është pra ky njeri një qafir, i pafe e një i pabesë?! ***A ngelet ndonjë gjë tjetër për të vërtetuar kufrin e tij të hapur dhe lajthitjen e tij të fëlliqur?!*** Pa dyshim që ai ishte një pjellë i politikës britanike, me të cilën ata u munduan të lëkundnin fenë tonë të qartë, fenë e Hazreti Muhamedit (alejhi selam) -që Allahu e ruajt-. Ky fundërrinë përgënjeshtroi Kuranin madhështor dhe Profetin tonë të madh ashtu siç doli kundra unanimitetit të këtij Umeti, duke ia kaluar kështu në kufrin e tij shokëve të tij të mëparshëm, shkaktarë të trazirave dhe problemeve. Falë Allahut dëshirat dhe qëllimet e tij humbën dhe u shkatërruan dhe atë pemë të mallkuar që ai do të mbillte do t'i pritëshin degët dhe rrënjët nga munda i dijetarëve të këtij Umeti, të cilët u çuan kundra saj me gjuhë me penë dhe me vendosmëri, (në Indi dhe Pakistan) ***'Ata duan që ta shuajnë dritën e Allahut më gojët e tyre porse Allahu do ta përsosë dritën e Tij edhe nëse këtë e urrejnë jobsimtarët'***.

Dhe së fundi bekimi i Allahut qoftë mbi të më mirin e krijesave, të parin tonë Muhamedin (alejhi selam) vulën e profetëve, prijësin e të devotshmëve, të parëve dhe të fundmëve. Bekuar qofshin familja e tij e ndershme, shokët e tij flamurtarë të fesë dhe ndaj të gjithë atyre që ndoqën më së miri rrugën e tyre deri në ditën e Kiametit.

الحمد لله الذي بنعمته تتم الصالحات

Përktheu në shqip nga arabishtja: J. Topulli, Mekë 1999.